



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201500254/8

Tiranë ___/___/2015

Lënda: *Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masës disiplinore ndaj Drejtorit të IEVP Lezhë z. Kanto Ndoi*

Drejtuar : **Z. Atur ZOTO**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

Tiranë

I nderuar zoti Zoto,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetësja V.D. me banim në fshatin Spitem, Lezhë. Ankuesja shkruan se, djali i saj B.D. në datën 07.02.2015 është ndaluar nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Lezhë. Sipas ankueses, djali i saj është keqtrajtuar fizikisht në mënyrë barbare nga punonjësit e policisë duke e goditur me mjete të forta. Si pasojë e keqtrajtimit fizik ai nuk ka lëvizur për disa ditë dhe prindërit e tij nuk janë lejuar që të takohen me të. Në datën 10.02.2015 B. është transferuar në IEVP Lezhë dhe kur ajo e ka takuar atë në datën 17.02.2015 ka konstatuar shenja dhune në trupin e tij. Ankuesja pretendon se, djalit të saj nuk i është dhënë dhe nuk po i jepet asnjë ndihmë mjekësore pas ushtrimit të dhunës fizike.

Për shqyrtimin dhe zgjidhjen e kësaj ankesë, bazuar në pikën 4, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: "*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*"; në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe konkretisht, në nenin 19, gërma "b" ku parashikohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qëndrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*"; si dhe në nenin 19, paragrafi i fundit, ku parashikohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme*", me shkresën nr. K2/V6-3 Prot., datë 25.02.2015 i kërkuam Drejtorit të IEVP Lezhë z. Kanto Ndoi që të verifikonte atë dhe të na dërgonte brenda 10 ditëve shpjegime lidhur me pretendimet e parashtruara nga ankuesja.

Ndonëse afati ligjor për kthimin e përgjigjes së shkresës tonë kaloi ai nuk na e dërgoi atë. Për të bërë të mundur shqyrtimin e rastit të ankueses u detyruam që me shkresën nr. prot., datë ta përsërisnim kërkesën tonë.

Ndërkohë nëpërmjet kësaj shkrese i kujtuam atij se detyrimi i organeve të administratës publike për të bashkëpunuar me institucionin e Avokatit të Popullit dhe për t'i kthyer përgjigje kërkesave të tij është parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj. Gjithashtu i bëme të ditur se ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, në nenin 22/1 të tij parashikon edhe të drejtën e Avokatit të Popullit për të kërkuar masa disiplinore ndaj punonjësve të administratës publike të cilët nuk bashkëpunojnë me të.

Megjithatë, edhe pas kërkesës së dytë ai përsëri nuk na e dërgoi përgjigjen e kërkuar nga ana jonë. Moskthimi i përgjigjes së kërkuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit është një nga rastet tipike të mosbashkëpunimit të punonjësve të administratës publike me institucionin tonë.

Ky qëndrim i Drejtorit të I EVP Lezhë me institucionin tonë ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve dhe në kthimin në kohë të përgjigjes ankueses. Ndërkohë ai cënon rëndë marrëdhëniet tona institucionale, si dhe imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik.

Për këto arsye, bazuar në nenin 22/1 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” ku parashikohet se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”*,

KËRKOJMË:

1. Fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masës disiplinore ndaj Drejtorit të I EVP Lezhë z. Kanto Ndoi.
2. Ky rast të përgjithësohet dhe t’u bëhet i njohur gjithë drejtuesve të I EVP-ve në vend me qëllim që të mos përsëritet më në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj kësaj kërkesë dhe masën disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI

